



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 77 Prot, Datë, 19.07.2019

Nr. 1586 Prot, Datë, 19.07.2019

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË  
SHKALLËS PARË, FIER

SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME  
DHE ANKESAT

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI "PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE TË HETIMIT"

Me synim për të rritur cilësinë e hetimit, ushtrimit të ndjekjes penale, për të parandaluar, zbuluar dhe dokumentuar veprat penale;

Me synim për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin institucional ndërmjet institacioneve të ngarkuara me ligj për të realizuar këto detyra;

Referuar problematikave të evidentuara në këtë periudhë kohore si dhe numrin në ulje të hetimeve proaktive dhe të referimeve të procedimeve penale;

Të bindur se bashkëpunimi ndërmjet institacioneve është vendimtar në luftën kundër paligjshmërisë;

**Bazuar në:** Ligjin Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 70/2014 "Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme".

"**Palët**" Prokuroria Pranë Gjykatë së Shkallë së Parë, Fier, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi duke rënë dakort për sa më poshtë:

#### Neni 1 Qëllimi i Memorandumit

- Rritja e efikasitetit dhe bashkërendimi i punës ndërmjet institacioneve.
- Realizimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënavë, nëpërmjet krijimit të një Task Force me pjesmarrës përfaqësues të të dyave institacioneve me qëllim forcimin e veprimeve të përbashkëta hetimore për çështjet që lidhen me korruptionin e zyrtarëve, lëndët narkotike, veprat penale në procesin zgjedhor, veprimet arbitrale dhe tejkalimin e kompetencave të policise së shtetit gjatë ushtrimit të detyrës.
- Koordinimi i punëve dhe realizimi i analizave të përbashkëta për fillimin e hetimeve, kryerjen e veprimeve hetimore, ndjekjen e rasteve me hetime proaktive.

## **Neni 2**

### **Institucionet zbatuese**

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Memorandumit janë:

- Prokuroria Pranë Gjykatë së Shkallë së Parë, Fier.
- Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

## **Neni 3**

### **Fusha e bashkëpunimit**

Fushat e bashkëpunimit për kryerjen e hetimeve të përbashkëta dhe shkëmbim informacioni apo të dhënave për veprimtari të kundërligjshme nga ana e subjekteve të SHÇBA-së, do jenë;

- a) Hetimet për implikime të subjekteve të SHÇBA-së, në rastet e kultivimit, trafikimit të lëndeve narkotike,
- b) Mbikqyrja dhe monitorimi i subjekteve policore në respektimin e ligjit në fuqi para, gjatë dhe pas proceseve zgjedhore.
- c) Mbikqyrja dhe monitorimi i subjekteve të SHÇBA-së, për zbatimin e ligjit në fuqi kryesisht të masave të ruajtjes se rendit dhe sigurise publike, në aktivitete të ndryshme social kulturore.
- d) Hetimeve për aktet korruptive, shpërdorimit të detyrës, favorizime të subjekteve të Shërbimit për lejimin e ndërtimeve pa leje, kryerjen e lojrave të fatit, etj
- e) Hetimet në lidhje me aktet korruptive në realizimin e prokurimeve publike nga ana e subjekteve të e SHÇBA-së.
- f) Hetimet në lidhje me respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive personale të njeriut, gjatë ushtrimit të detyres nga subjektet e SHÇBA-së.
- g) Si dhe çdo fushë tjetër, ku implikohen subjektit e e SHÇBA-së në përmbrashjen e rregullt të detyrës nga ana tyre.
- h) Të mbështesin trajnimet dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale, në fushën e hetimit.

## **Neni 4**

### **Administrimi i dokumentacionit dhe informacionit**

Çdo palë do ta trajtojë informacionin në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, Ligjit Nr 9887, date, 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligjit Nr 8457, date, 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar”, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Çdo palë do të garantojë shkëmbimin e informacionit për çështje sensitive.

Çdo palë do të zbatojë aktete ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen, sigurinë dhe fshehtësinë e të dhënave dhe përdorimin e kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e informacionit.

## **Neni 5**

### **Detyrimet e palëve**

Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të krijojnë grupin e punës Task Forcë, që të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi, sipas

parashikimeve të Ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 70/2014 “Për shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme“, si dhe normave të Kodit të Procedurës Penale.

**SHÇBA** angazhohet që të vërë në dispozicion të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, informacion referues për rastet e konstatimit të veprime në kundërshtim me ligjin apo mosveprimeve të punonjësve të policisë për referimin e veprave penale që lidhen me korruptionin, kultivimin e bimëve narkotike, veprave penale të kryera gjatë procesit zgjedhor, si dhe veprimet arbitrale të kryera nga punonjësit e policisë, sidomos në rastet e tubimeve apo protestave të lejuara sipas normave në fuqi.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË, FIER**, nga ana e saj angazhohet për krijimin e grupeve hetimore me qëllim ndjekjen e çështjeve me përparësi, kryerjen e analizave të përbashkëta hetimore, krijimin e lehtësirave të duhura për ndjekjen e hetimit me metodikat e nevojshme.

SHÇBA angazhohet që të mbështesë në terren grupin hetimor, duke vënë në dispozicion oficerë të policisë të strukturave të saj, të cilët do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit hetimor.

#### **Neni 6 Komunikimi**

Palët bien dakord të krijojnë një Task Forcë, të përbërë nga 3 anëtarë, një prokurorë, 1 përfaqësues të SHÇBA - së dhe 1 oficer i policisë gjyqësore pranë prokurorisë.

Palët brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të memorandumit njoftojnë me shkresë zyrtare emrat e personave të kontaktit (E-mail, numër telefoni) sipas linjave funksionale në të cilat do të zhvillohet bashkëpunimi. Edhe njoftimi i ndryshimit të personave të bëhet në të njëjtën rrugë.

Në rastet e shmangies nga detyrimet e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 7 Kryerja e analizave të përbashkëta**

Në interes të dokumentimit të plotë të veprimtarise së kundërligjshme, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, shpreh gatishmërinë sa herë të paraqitet nevoja nga ana e SHÇBA-së, për zhvillimin e analizave të përbashkëta periodike ose për procedime penale konkrete, dhënie konsultash për vleresimin e veprimeve proceduriale penale gjatë të gjitha fazave të hetimeve paraprake.

#### **Neni 8 Dispozitat e fundit**

Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përbahen parashikimeve ligjore, termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket shkëmbimit të informacionit, bashkërendimit të punës, realizimin e analizave të përbashkëta, realizimin e takimeve të Task Forcës së krijuar në zbatim të këtij memorandumi.

Memorandumi Bashkëpunimit hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve.


Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje originale, dy prej të cilave depozitohen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Fier, dhe dy të tjera në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat të Ministrise se Brendshme.

**Neni 9**  
**Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet me shkrim në çdo kohë me aprovimin e përbashkët të Palëve.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË  
SHKALLËS PARË FIER**

**DREJTUESI I PROKURORISË**



**SHËRBIMI I ÇËSHTJEVE TË BRENDSHME  
DHE ANKESAVE**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Muhamed BRUMBU LAKU

